



Bimba musulmana



Università di Tirana

UNË KAM QENË NË SHQIPËRI

Sa për fillim

Disa muaj më parë, ish-deputeti i Parlamentit italian dhe konsulli i nderit i Shqipërisë në Itali, Mario Brunetti, më kërkoi të bëhesha pjesë e kreut të institutit "Mezzogiorno Mediterraneo", themelues e president i të cilit është po ai vetë. E pranova me qejf këtë gjë, së pari ngaqë e çmoj tej mase zotin Brunetti, e së dyti ngaqë kjo ofertë do të më jepte mundësinë për t'u marrë me një lloj "tjetër" politike. Do doja fillimisht të njihja e më pas të jetoja realisht me pasojat e dramës, që ka pjellë sistemi globalizues, i cili përveç të tjerash përpin e gllabëron veçantësitë territoriale për t'i shtënë në punë për hesap të vet sipas një logjike hëm të thjeshtë, hëm meskine. Sot, në tërë globin, të pasurit mbrohen ngaqë janë të pasur, dhe të varfrit janë të mbajtur prore në prag të dëshpërimit, bash si për t'u dhënë mundësinë të pretendojnë ca më shumë: në fakt, jeta jo dinjitoze, më shumë mbjell frikën se sa nxit protestën e rebelimin.

Dhe kështu jam dhënë i tëri pas çështjes së mbrojtjes së pakicave, qofshin këto të fundit gjuhësore, etnike apo politike. Kam kuptuar dramën që një qytetërim pëson sa herë që duan ta fshijnë nga faqja e dheut, gjë që përbën një nga fyerjet më të mbrapshta e më shtazarake që mund t'i bëhen njerëzimit. Kam nisur pra të frekuentoj copëza të kësaj bote, që mezi ia del mbanë të mbijetojë. Stacioni më i parë në këtë rrugë e sipër, për shkak të natyrës specifike, për shkak të faktit ngaqë është fqinji ynë e për shkak të fjalëve plot dashuri të Marios, nuk mund të ishte, veçse Shqipëria.

Nami i keq

E shoqja e dajës tim është arbëreshe, nga San Martino di Finita, në provincën e Kozencës. Kur daja u fejua me të në vitet '60, të gjithë njerëzit e familjes iu hodhën përsipër...."si vidi nu ghieghiu e nu lupu, ammazza prima lu ghieghiu e ppue lu lupu" (nëse të zë rrugën një arbëresh e një ujk, vrit në fillim arbëreshin e pastaj ujkun).... Kjo thënie popullore shumë e përhapur njëherë e një kohë në Kalabri, edhe



Disperazione



pse përfaqëson mënyrën më të pahijshme, nëpërmjet së cilës shprehen njerëzit e pagdhendur e injorantë, pëshpëritet ende nga shpirtrat e kalabrezëve, ngaqë i jep zë rrjedhës historike të thadruar në kromozomet tona. Çfarë e ndoti më shumë imazhin e popullit shqiptar ishin valët e para të emigrantëve të dëshpëruar, që u përplasën në brigjet puljeze pas rënies së regjimit të Enver Hoxhës në fillim të dhjetëvjeçarit të shkuar. Zbarkuan me këto valë edhe njerëz të krimit në kërkim të tokave të xhambasllëqeve të reja. Dhe bashkë me ta sigurisht edhe njerëz të varfër e të skamur, që të gjithë njerëz për së mbari, të cilëve iu desh megjithatë e për fat të keq të dëshmonin aty për aty agresivitetin e tyre të formësuar në inkubatorin komunist për t'i bërë ballë kështu frikës dhe dhimbjes së madhe larg vendit të tyre. Përfunduan edhe këta të trajtoheshin njësoj si kriminelët në atë baltë ideologjike, që në fakt ishte thjesht gjykimi sipërfaqësor i italianëve të asaj kohe. Trashëgimia e vjetër kulturore dhe leximi i keq i atyre zbarkimeve të dëshpëruara ishin shkak, për të cilin ende sot, në shumë pjesë të Italisë shqiptarët konsiderohen të rrezikshëm, të pagdhendur e dembelë. Përveç kësaj, një qytetërim i zhvilluar, e mbi të gjitha një demokraci e denjë në tokën e Atit të Shenjtë, nuk do të duhej të pranonte një ligj si ai Bossi-Fini, që e kushtëzon hyrjen e qëndrimin e të huajve në Itali me faktin e të qenit i punësuar apo jo. Njerëzit trajtohen kështu si mall shkëmbimi.

Përshtypjet e para

Teksa lexoj me të mbërritur në aeroport emrin e heroinës së bujarisë së krishterë, Nënë Tereza, e kap veten më të qetë se një deqikë më parë. Fuqia evokuese e atij emri nuk shkon me asnjë lloj ankthi. Marr vulën në pasaportë dhe dal jashtë, jo dhe aq i qetë, por gjithsesi më i qetë. Ndalem një metër larg kangjellave të aeroportit, hedh rrotull një vështrim të pudrosur me mosbesim si për t'u mbrojtur nga kushedi se çfarë e kushedi se kush. Por aty për aty fitoj vetëdijën e të qenit i mbrojtur, dhe e gjej veten po aq shend e verë sa një nevrotik, kur kupton se paniku po e lë shpirtin e tij të ligështuar. Nuk më duhet shumë për të kuptuar se nuk jam i rrezikuar nga asgjë. Marr për nga

Ragazze griffate a passeggio nel "Blocco"



Autobus di Tirana



drejtimi, ku ndodhen të parkuara makinat e ku më pret një miku im. Çapitem nën ledhatimet bezdisëse të ca varfanjakëve në kërkim të qindarkave, duart e të cilëve i ndjej mbi pallto. Provoj turp e trishtim, por nuk e di saktësisht se pse.

Dyshimet e para

Edukimi im në shkencat humane, përvoja e kaluar si njeri mes njerëzve, njohja diskrete e doktrinave filozofike e politike, praktika gazetareske, të gjithë këto pra më shtyjnë të përmbush kureshtjen e të thellohem, duke kërkuar gati në ankth të njoh shumë njerëz, të cilët dua t'i pyes e t'i hetoj. Më duhet të dëshmoj me vonesë, me dhimbje e zemërim në favor të një populli dinjitoz e të pafajshëm, që është dënuar tashmë nga oksidenti fals e mondan, të cilit unë i përkas. Dhe kështu filloj t'i jap një fytyrë turp të trishtimit: është një imazh i palosur mbi vetveten, është imazhi im.

Njohja e vërtetë

Ndjeshmëria e përfutur prej dhimbjes nga jetë shqiptare të vizatuara më sipër me ngjyra gri dhe ndjesia e të zotëruarit të një fuqie jo të zakonit – kjo fuqi do të më ketë ardhur ndoshta prej faktit që u ndala një copë herë të madhe poshtë statujës së Skënderbeut? – e ushqenin me goxhá entuziazëm qëndrimin tim në Tiranë. Ndihem si në parajsë, ndërsa deri në ato momente kisha besuar të ndeshesha me ferrin. Dhe kështu, më rrëmben dëshira për "të perceptuar" njerëz të ndryshëm sa më shumë të jetë e mundur: Njoha shumë vetë, burra e gra, dhe me secilin e me secilën prej tyre fola gjerë e gjatë. Sa më shumë i dëgjoja, aq më shumë më kapte zemërimi, ngaqë unë, edhe pse jam partizan i bindur i idesë se gjykimi në këtë botë është i papraktikueshëm, e kisha parë veten shpeshherë në kurthin e paragjykimeve homologuese. Bashkëbiseduesit e mi bëhen njëri pas tjetrit gjithmonë e më shumë shqyrtues. Më përshëndesin me një buzëqeshje mikpritëse. E duan Italinë bash si (ndoshta ca më shumë se) bijtë e Ulkonjës e kanë një njohje të plotë mbi ne. Bëjnë tifozllëk për Milanin, Juven, Interin... Në mbrëmje vijnë në ndjekin në TV programet e RAI-t e të Mediaset-it,

Grattacielo di Tirana



Nonna e nipotini al parco



Piazza Skanderberg

idhulli i tyre është Celentano. E ndjej veten të rrethuar me aq dashuri, sa më duket se nuk jam jashtë Italisë. Rrëfimet e hallevë e vuajtjeve të tyre dinjitoze të mbajnë në prag ngashërimit. Është e vështirë dhe e dhimbshme të ndahesh nga secili prej tyre; dhe mes tyre të duket se je apostulli më i dashur prej Jezuit, i Jezuit të së famshmes puthje të fundit.

Përvoja ime

Pravgoj qetësisht e natën nëpër Tiranë, me duart në xhepat e kapotës sime, që e ndjej të tepërt mbi supe. As që më cek ideja se mund të ndeshem me rrugaçë të prishur mendsh, por edhe sikur të më bënte vaki një gjë e tillë, thjesht do të paguaja një porcion të borxhit që ndjej se u kam këtyre njerëzve. Një burrë i vjetër shet gështenja të pjekura. I kërkoj një dorë gështenja, dhe i jap dhjetë euro në dorë. Ai hap krahët dhe më buzëqesh, sikur do të më thotë: "E ku ta gjej reston"? I marr monedhën dhjetë euro-she nga duart, i kthej gështenjat me aromën e tyre të mirë, dhe bëj të iki. Por dora e gështenjxhiut që ngrihet lart dhe buzëqeshja e tij e ëmbël më bëjnë të ndal çapat. Më thotë t'i marr gështenjat e se mund të paguaj njëherë tjetër, kur të kem të thyera. Pak më tej, sytë të shohin një nënë të dëshpëruar, teksa rehaton foshnjën e vet mbi kofanin e një makine të parkuar buzë rrugës, dhe kështu gjen kohë për të hedhur një sy brenda kazanit të plehrave aty pranë.

Duke shëtitur nëpër udhët e Bllokut (zona rezidenciale e ish-nomenklaturës komuniste) më kapin sytë nga njëra anë vajza të pispillosura e elegante e nga ana tjetër njerëz, të cilët për të jetuar lustrajnë këpucë, shesin gështenja, apo thjesht të kërkojnë një cent në këmbim të ledhatimit të tyre me duar.....

.....Ja, kjo është Shqipëria që unë pashë. Unë kam qenë në Shqipëri.

(*) – Ermanno Cribari, doktor në Filozofi dhe bashkëpunëtor i disa gazetave italiane

